


KRITIKË E BIBLIOGRAFI

J. THOMAI: «PREJARDHJA SEMANTIKE NË GJUHËN SHQIPE»

(Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1989)



Kjo vepër e re, që i paraqitet lexuesit si një variant më i zgjeruar i disertacionit të mbrojtur nga autor i 1983 për gradën shkencore «doktor i shkenca filologjike», i kushtohet prejardhjes kuptimore në gjuhën shqipe. J. Thomai ka ndjekur kështu hullinë e hulumtimeve të mëparshme, që e kishte shestuar qysh në monografitë «Cështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe» (1981) «Leksikologjia e gjuhës shqipe» (1984, tekost mësimor për studentët e gjuhës shqipe në shkollat e larta) dhe në një numër artikujsh studimorë, të botuar gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është interpretimi, zgjidhja ose shtrimi i disa çështjeve të rëndësishme të semantikës leksikore të shqipes, që i ka nxjerrë vetë zhvillimi i gjallë i gjuhës shqipe në kohën tonë. Të tilla janë ato që lidhen me strukturën kuptimore të fjalëve, me njësitë kryesore të semantikës, me

kuptimin leksikor e përbërjen e tij, me lëvizjet semantike në leksik, me prejardhjen e kuptimeve e lidhjet ndërmjet tyre, me kufijtë e polisemisë e të homonimisë, me ndryshimet që ndodhin në semantikën e fjalëve gjatë fjalëformimit, me veçoritë e zhvillimit të kuptimeve në disa klasa të mëdha leksikore etj.

Pasqyra e lëndës (f. 3-4) dhe parathënia e thukët (f. 5-7), ku paraqiten përbledhtas qëllimi dhe ndërtimi i punimit; e nxitin lexuesin të hyjë që në fillim në temën e vështirë që shqyrtohet. Ndërsa bibliografia e pasur në fund të punimit (f. 331-339) dëshmon më së miri për seriozitetin e ndërmarrjes së këtij studimi.

Punimi përmban pesë krerë, të ndarë në sytha me nëntituj të veçantë, që e paraqesin lëndën mjaf qartë dhe në mënyrë të kapshme si për specialistët, ashtu edhe për një masë të gjerë të interesuarish. Vepra ka nivel të lartë shkencor, stil të përpunuar e gjuhë të rrjedhshme, që e bëjnë tërheqës leximin edhe pse jemi në një fushë të vështirë. Do të ishte mirë që punimi të kishte edhe një përbledhje në gjuhë të huaj, çka do ta bënte të përdorshëm edhe për ata studiues të huaj që janë të interesuar përgjuhën shqipe.

Në kreun e parë (*Hyrje, Vështrim kritik, nocione themelore*, f. 9-92), pasi jepet një pasqyrë e përbledhur e semantikës leksikore të shqipes dhe e semasiologjisë si shkenca për kuptimin, shtjellohen dhe shoshiten me vështrim kritik qëndrimet për dukuri të tillë, si: fjala, kuptimi leksikor, struktura kuptimore, lëvizjet kuptimore, ngjyrimi emocionues, fushat leksikore e semantike etj. Paraqitet gjithashtu një sistem konceptual teorik me nocionet themelore e me metodën e nevojshme të analizës, që janë parakusht për shqyrtimin e thelluar të lëndës konkrete të shqipes. Autori operon me nocione të tillë, si: *fjala (leksema)*, *kuptimi (semema)*, *përbërësi i kuptimit (sema)* etj., duke parapëlqyer kështu metodën e analizës *kuptimore* (semike) të fjalës, *ndryshe* nga analizat sipas përbërjes (komponenciale) dhe shpërndarjes (distribucionale). Kjo metodë, që qëndron në bazë të gjuhës së sotme funksionale, e ka burimin tek analiza e «tipareve dalluese», që po zbatohet me sukses në disiplinat e tjera gjuhësore, si fonologjia dhe morfologjia. Natyrisht, ajo është zbatuar nga autori në mënyrë kritike, mbështetur mbi baza të shëndosha metodologjike, duke mos harruar

për asnjë qast unitetin dialektik midis realitetit, mendimit dhe gjuhës.

Në kreun e dytë (*Lëvizjet kuptimore brenda fjalës. Tipat e prejardhjes semantike*, f. 93-167), siç del edhe nga titulli, i nënshistrohet një trajtimi të mirëfilltë gjuhësor struktura kuptimore e fjalës, me dinamikën e saj të përhershme. Autori përpinqet të qartësojë shkaqet dhe mënyrën e lindjes së kuptimeve të reja përnjësítë e ndryshme leksikore, tipat dhe shkallët e shndërrimeve kuptimore, zgjerimin e strukturës kuptimore të fjalëve etj.

Pavarësisht nga numri i kuptimeve që ka një fjalë, çdo kuptim leksikor në vetvete paraqet një strukturë që mund të zërthehet më tej në disa përbërës. Ndryshimet e përbërësve nga një kuptim në tjetrin nuk janë të njëjtë as nga sasia, as nga cilësia, e kjo sjell dallime të dukshme në tipin e lëvizjeve kuptimore. Këta përbërës edhe brenda një kuptimi leksikor nuk janë të një shkalle për nga rëndësia. Që këtej autorri vjen në përfundimin e përgjithshëm se vetëm kur ndryshon shumica e përbërësve ose kur ndryshojnë përbërësit kryesorë, atëherë kemi një kuptim të ri leksikor.

Këto përfundime autorri i zbaton me sukses gjatë analizës semantike të emrave të lëndës, në të cilët vija e përgjithshme e lëvizjeve kuptimore shkon zakonisht nga lënda te sende të bëra me këtë lëndë, ose nga lënda te sende që kanë tipare të spikatura të kësaj lënde.

Meritë tjetër e autorit është se ai bën dallim midis lëvizjeve në kuptim dhe ndryshimeve në formë. Kuptimi ndryshon më shpejt e më thellë se forma. Për më tepër, faktorët jashtëgjuhësorë më shumë e më drejtpërdrejt veprojnë mbi përbajtjen.

Por lëvizjet semantike nuk mund të mbeten brenda strukturës kuptimore të fjalës. Në leksikun e shqipes qëmtohet një numër jo i vogël rastesh, kur një kuptim largohet nga kuptimi kryesor i fjalës dhe humbet lidhjet me të, duke çuar në përfimin e një homonimi të ri. Kjo dukuri përbën objektin e studimit të kreut të tretë (*Kalimi nga njësi semantike në njësi leksikore. Çështje të lidhjes polisemi-homonimi*, f. 168-231).

Këtu J. Thomai ftillon lëvizjet kuptimore në gjuhë si zhvilime të shkallëshkallshme: *shkalla e parë* – lindja e një përbërësitetë ri semantik, *shkalla e dytë* – lindja e një nuance të re kupti-

more; *shkalla e tretë* – lindja e një kuptimi të ri leksikor; *shkalla e katërt* – formimi i bloqeve semantike me nyjet semantike përkatëse dhe *shkalla e fundit* – formimi i homonimeve. Kjo është shkalla më e lartë e polisemantizmit në kuptimin e dallimit (e diferencimit) semantik.

Pranimi i homonimisë së përfthuar edhe me këtë rrugë është deri-diku i ri në disiplina gjuhësore. Për dallimin e saj nga polisemia autori zbaton disa kritere gjuhësore, siç janë analiza semantike dhe kundërvënia e struktura semantike, aftësitë kuptimformuese, veçoritë paradigmatike, valencat sintagmatike etj.

Në këtë krye kemi gjithashtu një studim sintezë për dukurinë e homonimisë në gjuhën shqipe, duke u kushtuar rëndësi të vëçantë homonimeve me lidhje etimologjike. Këtu autori bën syzime të hapëta, që ia rrisin edhe më shumë vlerën punimit.

Me formimin e homonimeve nëpërmjet shpërbërjes së polisemisë ngjason, në mjaft hallka edhe formimi i fjalëve të reja. Kjo është edhe arsyja që J. Thomai i kushton një vend të vëçantë në punim edhe prejardhjes semantike në sistemin e formimit të fjalëve. Kreu i katërt (*Lëvizje kuptimore brenda çerdhes së fjalës. Formimi i fjalëve dhe prejardhja semantike*, f. 232-289).

Autori me të drejtë vëren se sistemin e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe e përshkojnë dy vija kryesore që ndërthuren me njëra-tjetrën: Vija e parë ndërtohet nga madhësitetë themelore që përbëjnë vargun e hallkave kryesore të formimit të fjalëve (*fjalë prodhuese – tema – ndajshtesa – fjalë e prejardhur*). Kjo vijë jep mundësinë të ndiqet rruga e formimit të njësive të reja leksikore e të përvijohet sistemi fjalëformues i gjuhës shqipe. Ndërsa vija e dytë ndërtohet nga lidhjet kuptimore që përshkojnë vargun e hallkave të mësipërme dhe që shpjegojnë lëvizjet e kuptimit nga një hallkë në tjetrën. Këtë vijë që përbën sistemin semantik brenda sistemit fjalëformues, autori ia nënshtron një hulumtimi të vëçantë. Këtu ai shqyrton, ndër të tjera, modelet e formimit të fjalëve në shqipe, llojet e ndryshme dhe lëvizjet kuptimore gjatë fjalëformimit, specializimin kuptimor të ndajshtesave etj.

Në përcaktimin e gjedheve fjalëformuese në gjuhën shqipe autori përqendrohet në katër klasat kryesore leksiko-gramatikore (*emri, mbiemri, folja, ndajfolja*), por mund dhe duhej të zgjerohej edhe në klasat e tjera, për të na dhënë më të plotë sistemin fjalë-

formues të shqipes së sotme. Gjatë këtyre analizave ai vjen në disa përfundime me vlerë për sasinë e gjedheve fjalëformuese që zotëron shqipja (rreth 200), për temën më prodhimtare në shqipe, që është tema emërore etj.

Krahas kësaj, autori klasifikon edhe lëvizjet kuptimore sipas elementeve të ndryshimit, në: a) ndryshime të kuptimit kategorial (gjithsej 87 gjedhe), b) ndryshime të kuptimit leksikor të fjalës ose të klasës së fjalëve. Ky kuptim merr pjesë edhe në ato vargje, ku ndodhin ndryshime të kuptimit kategorial; c) ndryshime të përbërësve plotësues me vlerë të njësive semantike themelore, siç janë nuancat e shkallës së intensitetit të veprimit, të përsëritjes, të përforcimit etj. Këto zhvillime kuptimore u përkasin modeleve fjalëformuese të së njëjtës ligjëratë (*qelq—qelqurina*) etj.

Në kreun e fundit (*Përfundime. Probleme dhe detyra*, f. 290-330) jepen disa përgjithësime më të gjera, që dalin nga vështrimi gjithëpërfshirës i lëvizjeve kuptimore në fushë të shqipes, duke ndërtuar një pasqyrë pak a shumë të plotë për llojet e lëvizjeve e të lidhjeve semantike në strukturën semantike të shqipes dhe duke përcaktuar vendin që zënë në to lëvizjet dhe lidhjet sipas prejardhjes semantike. Vihen në dukje gjithashtu disa nga vijat më kryesore që karakterizojnë gjuhën shqipe në shndërrimet kuptimore dhe në tipat e prejardhjes semantike.

Lexuesi e ndien nevojën që punimi të kishte në fund një tregues të çështjeve dhe të njësive leksikore që u janë nënshtruar analizave të mirëfillta semantike.

I përfundojmë këto radhë me mendimin se «Prejardhja semantike në gjuhën shqipe» shënon një moment kulmor në veprimtarinë shkencore të J. Thomait; ajo është një nismëtare e mbarë e një disipline gjuhësore të re dhe kaq të vështirë.

BARDHYL DEMIRAJ